



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 54, DATË 05.08.2020

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 183, DATË 19.12.2019, TË AMA-S, "PËR
MIRATIMIN E PROJEKTBUXHETIT PËR VITIN 2020", TË NDRYSHUAR,
PËR VIJIMIN E FUSHATËS SË INFORMIMIT TË PUBLIKUT PËR
PROCESIN E DIGJITALIZIMIT NË QARQET ELBASAN, SHKODËR,
LEZHË DHE VLORË

Në mbështetje të nenit 19, pika 13, të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Autoriteti i Mediave Audiovizive:

VENDOSI:

1. Miratimin e një ndryshimi në vendimin nr. 183, datë 19.12.2019, të AMA-s, "Për miratimin e projektbuxhetit për vitin 2020", të ndryshuar, për vijimin e fushatës së informimit të publikut për procesin e digjitalizimit në qarqet Elbasan, Shkodër, Lezhë dhe Vlorë, në zërat si më poshtë:

Zëri i parashikuar:

**Shpenzime të pritshme
(ishte)**

"Shërbim i fushatës së informimit të publikut mbi procesin e digjitalizimit"	21,408,401 lekë
"Pajisje për monitorimin dhe regjistrimin e shfrytëzimit të spektrit audio FM, në Elbasan, Pogradec, Lezhë dhe Sarandë"	5,000,000 lekë
"Shpenzime për vendime gjyqësore"	24,892,616 lekë

Zëri i parashikuar:

**Shpenzime të pritshme
(bëhet)**

"Shërbim i fushatës së informimit të publikut mbi procesin e digjitalizimit"	31,340,401 lekë
"Pajisje për monitorimin dhe regjistrimin e shfrytëzimit të spektrit audio FM, në Elbasan, Pogradec, Lezhë dhe Sarandë"	0 lekë
"Shpenzime për vendime gjyqësore"	19,960,616 lekë

2. Ngarkohet administrata e Autoritetit të Mediave Audiovizive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:

Gentian SALA

Zëvendëskryetar:

Sami NEZAJ

Anëtarë:

Agron GJEKMARKAJ

Gledis GJIPALI

Suela MUSTA